

Shtojca 10

**PLANI PËR MENAXHIMIN ME MJEDISIN JETËSOR DHE ASPEKTET SOCIALE
PËR PROJEKTIN "RIVITALIZIMI I KALASË SË KITËS"**

KOMUNA E KËRÇOVËS

korrik viti 2018

Hyrje

Projekti i konkurrencës lokale dhe rajonale (PKLR) është një operim investues katërvjeçar, i mbështetur nga Bashkimi Evropian përmes Instrumentit të Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA II) dhe i dizajnuar për konkurrencë dhe inovacion në Maqedoni. Projekti zbatohet nga Kabineti i Zëvendës Kryeministrit përgjegjës për Çështjet Ekonomike, ndërsa administrohet nga Banka Botërore. Objektivi kryesor i Projektit për konkurrencë lokale dhe rajonale është të forcojë kontributin e turizmit në zhvillimin ekonomik lokal dhe të rrisë kapacitetet e Qeverisë dhe institucioneve publike në mënyrë që të nxisë zhvillimin e turizmit dhe të lehtësojë menaxhimin e destinacioneve. PKLR-ja do të sigurojë fonde për ndërtimin e kapaciteteve që do të kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të turizmit, investimet në destinacione dhe mbështetjen e progresit të tyre. Projekti do të mbështesë destinacionet e zgjedhura turistike në vend përmes një kombinimi të mbështetjes teknike për të përmirësuar menaxhimin e destinacionit, investimet në infrastrukturë dhe investimet në inovacion.

Ky Plan i menaxhimit me mjedisin jetësor dhe aspektet sociale (PMMJAS), duke përfshirë Planin e menaxhimit me trashëgimisë kulturore, i referohet aktiviteteve të parashikuara në kuadër të projektit "Rivitalizimi i Kalasë së Kitës" në Komunën e Kërçovës. PMMJAS përfshin një përshkrim të projektit, detaje teknike dhe një përshkrim të rajonit dhe vendndodhjes. Bazuar në këto parametra, ai vlerëson rreziqet për mjedisin jetësor dhe social, si dhe rreziqet që lidhen me trashëgiminë e paluajtshme kulturore. Zbatimi i masave lehtësuese dhe monitoruese që identifikojnë rreziqet dhe çështjet e identifikuar në PMMJAS është i detyrueshëm.

1. Përshkrimi i projektit "Rivitalizimi i Kalasë së Kitës"

Kalaja e Kitës është një lagje e përcaktuar nga Epoka e Bronzit dhe Hekurit dhe nga Mesjeta, një vend arkeologjik që ka mbijetuar për shumë vite. Sipas të dhënave ekzistuese, kjo është lagja më e vjetër në qytet. Legjenda thotë se kjo kodër i përkiste dukeshës Kita, një nga motrat e Mbretit Marko, e cila ishte arsyeja pse ajo u quajt Kalaja e Kitës, dhe supozohet se qyteti i Kërçovës, u emërua sipas saj.

Vendosur në një pozitë dominuese në qendër të qytetit, Kalaja e Kitës në Kërçovës paraqet një kompleks park me shtigje rekreative, për shëtitje dhe objekte shoqëruese, që në periudhën e kaluar kanë mundësuar përmbushjen cilësore të kohës së lirë dhe organizimin e ahengjeve dhe ngjarjeve të ndryshme. Si rezultat i pakujdesisë së gjatë të këtij lokaliteti, kompleksi është shkatërruar, neglizhuar dhe rrallë është vizituar. Kohën e fundit, komuna ka investuar përpjekje dhe të siguroj mjete për avancimin e shtigjeve drejt majës së kalasë, ndërsa u realizua dhe ndriçimi i kompleksit. Me rindërtimin në frontin para objektit të rrënuar (rregullim të katit përdhësë dhe duke e mbushur me pllaka të granitit jo rrëshqitëse për përdorim të jashtëm), rindërtimin e fontanës, rregullimin e shtigjeve qasëse (sanimin e shtigjeve dhe zëvendësimin e pllakave të dëmtuara të bekatonit), duke theksuar trashëgiminë kulturore dhe mbetjet arkeologjike në terren (ndërtimi i konstruksionit metalik me një pikë referimi të një pamjeje të supozuar të kullave, të mbetjet e pranishme), rregullim hortikulturor (gur të grimcuar dekorativ dhe pjesë/copëz zbukuruese nga bari), duke krijuar përmbajtje të re (këndi për fëmijë me elemente të ngulitura për të luajtur, rrëshqitëse, ulëse për të ndejtur dhe komplet shahu për pensionistët, shteg për vrapim dhe pajisje fitnesi për rekreim, ndërtim amfiteatral metalik dhe skena verore pjesërisht e mbuluar me një kulm metalik) dhe duke vendosur pikëpamjen (ndërtim nga çeliku, në të cilën vendoset një stol i drurit të ahut), kompleksi do të integrohet në indet urbane të qytetit. Riorganizimi i hapësirës dhe shfrytëzimi i lidhjes brenda-jashtë dhe rikonstruimi i ndërtesës së rrënuar me shëndërrimin në një qendër multimediale, do të mundësojnë një shumëllojshmëri të përmbajtjeve, të tilla si një bar kafe, shfaqje kinemaje, koncerte, ngjarje kulturore, seminare, punëtori etj. Objekti që është lëndë e rikonstruimit në këtë projekt është i

kategorisë B. Në të kaluarën ishte restorant, i cili gjatë kohë ishte aktiv. Ndërtesa më vonë u shfrytëzua si radio stacion. Megjithatë, i lënë pas dore aq shumë vite, sot kjo ndërtesë nuk është diç tjetër përveç se një rrënojë. Për rikonstruimin dhe adaptimin e objektit për nevojat e parapara në pajtim me rivitalizimin e planifikuar të kalasë, në pajtim me dokumentacionin teknik, do të kryhen punët dhe aktivitetet vijuese: Furnizim me ujë në fazë dhe kanalizim (furnizim me ujë do të lidhet me një degë ekzistuese të rrjetit për ujë të qytetit), faza – energjia elektrike (lidhja e objektit me rrjetin elektrik), adaptim në fazë dhe rikonstruim i objektit (rinovim i tërësishëm dhe lëshimi në shfrytëzim). Njëherit, të gjitha fazat, sipas dokumentacionit teknik, kyçin aktivitete siç janë: punë përgatitëse, punë në lidhje me trotuarët, izolim, punë ndërtimore, punë të përpunimit të metaleve, punë me llamarinë, zdrukthari, punë me beton, punë me qeramikë, punë me lysterje dhe ngjyrosje dhe instalim të pajisjes urbane. Janë të parapara edhe punë me tokë. Kjo ngërthen gërrmimin e tokës për ujësjellje dhe kanalizim, si dhe punë për furnizim me energji elektrike të objektit. Është përgatitur elaborat për mbrojtjen nga zjarret, eksplozimet dhe materiali i rrezikshëm, me qëllim që të sigurohet mbrojtja e objektit. Skena e verës është skenë e hapur, e cila sipas Projektit, është e vendosur në hapësirën para përmendores - përkujtimore dhe parashih pllakëzimin e sipërfaqes (hapësira – sipërfaqja e kulmit që ngërthen pjesë më të madhe mbi përmendoren memoriale, me përjashtim të pjesës nën ku gjendet vetë përmendorja). Përmendorja memoriale është një lloj Përkujtimore, e ndërtuar në vitet e pesëdhjeta të shekullit të kaluar. Gërmadhat e luftëtarëve të rënë ruhen në një dhomë të vogël në pjesën lindore të përkujtimores. Në kohën e ndërtimit të përmendores ka qenë e dëmtuar një pjesë e trashëgimisë kulturore të kalasë ekzistuese. Sot është në gjendje të keqe e shkaktuar nga ujërat atmosferikë, që nuk ka trajtim cilësor dhe adekuat edhe përkundër përpjekjeve për fillimin e ndërtimit të kanalit të drenazhit, projekt ky i inicuar nga komuna në bashkëpunim me Qendrën konzervatorike – Shkup. Me ndërtimin e skenës së hapur të verës, do të kryhet mbrojtja përfundimtare e përmendores, ndërsa në vendin do të kyçen aktivitete të reja në interes të të gjithë vizitorëve. Për rivitalizimin e skenës së verës do të realizohen punë ndërtimore, punë të betonit, përforsim dhe punë të montazhit. Projekti bazohet në mendim e ekspertëve të Qendrës konzervatorike – Shkup dhe ngërthen kushte të cilat nuk lejojnë gërrmimin më të madh se 0,20 m. Pas përfundimit të aktiviteteve projektuese për rehabilitimin e kalasë, në pajtim me planin për qëndrueshmëri, planifikohet të vendosen kamera, si dhe shërbim sigurie, me qëllim që të sigurohet mbrojtje dhe qëndrueshmëri.

Duhet të theksohet se gjatë kohës së realizimit të aktiviteteve të planifikuara, si për objektin, ashtu edhe për skenën e hapur të verës, nuk parashihet prerja e drunjëve ose dëmtimi i objekteve që janë nën çfarëdo mbrojtje. Natyra e vendeve dhe vetë punëve që realizohen është e atillë që nuk ekziston asnjë prishje e atij lloji.

Pamja e re dhe aktivitetet e reja të parashikuara, si dhe afërsia e kompleksit me qendrën e qytetit, do të mundësojnë ky lokacion të jetë i mirënjohur dhe pjesë e jetës së përditshme, që do të ndikojë në cilësinë e jetës dhe dobi ekonomike të komunës.

Kalaja e Kitës është një potencial i madh turistik, në të gjitha bazat e përcaktuara si një tërheqje ekzistuese që është përdorur plotësisht në të kaluarën. Për shkak të gjendjes aktuale të shkatërruar, për momentin ky vend mund të perceptohet vetëm si potencial. Në qoftë se, do të ketë disa ndërhyrje dhe të vihet në veprim, sipas parashikimeve të projektit, Kalaja e Kitës do të bëhet një destinacion tërheqës, tërheqje e njohur turistike, në të cilën gëzimin e tij do të gjejnë lloje të ndryshme të vizitorëve vendas dhe të huaj. Vendndodhja në qendër të qytetit siguron komunikim, gjegjësisht qasjen e këmbësorëve dhe trafikut, dhe nga maja e kodrës ofron një pamje të bukur të qytetit dhe rrethinës së tij. Në afërsi ka një

numër të madh të kapaciteteve hotelierike dhe tregtare që ofrojnë shërbime të ndryshme për ngrënie, zbavitje, akomodim për fjetje etj.

Kalaja e Kitës paraqet një monument të rëndësishëm të kulturës, një vend arkeologjik - një kështjellë më të vogël të fortifikuar (opidulum), e cila gëzon mbrojtje të garantuar. Nga Instituti Republikan për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, u miratua një aktvendim për të përcaktuar statusin e një monumendi kulturor me nr. 08-561 të dt. 25.04.1990. Duke pasur parasysh se është një objekt kulturor i mbrojtur ose një vend arkeologjik, aktivitetet që do të realizohen në vendin e Kalasë së Kitës, do të jenë në përputhje me kushtet e përcaktuara për të siguruar ruajtjen e vlerave të saj.

Aktivite të planifikuara

Bazuar në situatën aktuale, ka shumë gjëra për të zëvendësuar dhe rindërtuar, por ka disa ide të reja për hartimin dhe zbatimin nga zeroja, në mënyrë që të arritet në rezultatin kryesor të këtij nënprojekti për të ringjallur Kalanë e Kitës dhe transformimin e saj në kompleks funksional dhe të rindërtuar për rekreim dhe relaksim të vizitorëve. Për këtë qëllim, Komuna e Kërçovës planifikon aktivitete për rivitalizimin e plotë të Kalasë së Kitës, me çka do të ndryshojë gjendjen aktuale të dobët që është e pranishme në vendndodhje.

1. Projekti përfshin rikonstruimin e pllajës para ndërtesës së mëparshme të restorantit, që ndërthen pllakëzimin me pllaka të granitit, vendosjen e paisjes urbane dhe rregullimin hortikulturor të shëtitores me barë, gurë dekorativ dhe drunjë, rikonstruimin e fontanës ekzistuese, si dhe rikonstruimin e ndërtesës ekzistuese të rrënuar (restoranti i mëparshëm), duke ndërthyer infrastrukturë për ujësjellje dhe kanalizim. Në lokacionin e dhënë nuk ekzistojnë rrjete të reja të instaluara dhe infrastrukturë, por për nevojat e objektit, do të sigurohet lidhje me rrjetin ekzistues të ujësjelljes. Një pjesë e rrjetit të ujësjelljes kalon nëpër lokacionin (lokacionin e projektit), deri te pllaja para ndërtesës, që mundëson me intervenim të vogël prej 100 metrash, objekti të jetë i lidhur me rrjetin lokal për furnizim me ujë. Në brendësi, vetë objekti mundëson furnizim me ujë përmes instalimit të paraparë për furnizim me ujë. Sa i takon rrjetit të kanalizimit fekal, është e paraparë mënjanimi i ujërave të zeza të dërgohet deri te gropa septike ekzistuese. Nga ndërtesa deri te rezervuari ekzistues septik, ka gypa PVC f 150 mm, të vendosur në trap me rërë të rrafshuar dhe të groposur me dhe (në gjatësi më të vogël prej 20 m). Në ndërtesën, PVC gypi hyn nën pllakën e përdhësës, nga i cili ndahet gyp PVC horizontal prej 100 mm për lidhje.

2. Rregullimi i 2 shtigjeve ekzistuese qasëse duke kyçur rihabilitimin e vendparkimit ekzistues (kapacitet prej 17 automjeteve), vendosjen e shtresës dhe zëvendësim të pllakave të dëmtuara ose asfalt të dëmtuar, si dhe theksimin dhe ndriçimin e trashëgimisë kulturore dhe mbetjeve arkeologjike të terrenit, përmes ndërtimit të konstruksionit metal me pamje të supozuar të kullës, do të sigurojë përjetësim të këndshëm vizuel të kompleksit.

3. Vendosja e aktiviteteve të reja ndërthen: ndërtimi i këndit për fëmijë dhe penzionistë (këndi i fëmijëve ndërthen instalim të rekuizitëve për të luajtur (sllajde, kërcyese, luajtëse), vendosjen e setit të shahut për vizitorë më të vjetër), kënd për fitnes dhe vendosjen e pjergullës (strukturë me ndenjësë prej druri që do të sigurojë rahat, pushim, relaksim dhe pamje të bukur për vizitorët).



Fotografia 1 dhe fotografia 2 Gjendja aktuale e sipërfaqes para objektit




Fotografia 3 Pjesë e ngelur e kullës mesjetare

Fotografia 4, fotografia 5 Shtigje që çojnë deri te objekti për rikonstruim dhe deri te Përkujtimorja-Kulla në kulmin e Kalasë së Kitës

4. Vendosja e skenës së verës dhe amfiteatër të lëvizshëm, do të kontribuoj, për përjetësimin e kompleksit. Paisja urbane (ndenjese dhe shporta) do të vendosen në disa lokacione në kompleksin. Rregullimi i pllajës për skenën e verës (vendosja e kulmit të mbuluar pjesërisht dhe konstruksion të metalit në të cilin vendosen ndenjese të drurit), do të siguroj mundësi për organizimin e ngjarjeve të hapura që do të kontribuojnë për ofertën e begatshme kulturore të qytetit, lëvizjen e vizitorëve dhe dinamikën e hapësirës.



Fotografia 6 Përkujtimore – Kullë




Fotografia 7 Sipërfaqja e Përkujtimores – Kullës (pamja e skenës verore)

Aktivitetet e planifikuara për rivitalizimin e kompleksit të Kalasë së Kitës përfshijnë:

- Aktivitetet ndërtimore për përshtatjen / rindërtimin e një ndërtese ekzistuese dhe një fontane, që përfshijnë planifikimin paraprak, argjilën, izolimin, muratimin, përpunimin e metaleve, fletë metalike, beton, montazhi dhe punimet në fasadë.
- Rehabilitimi i një infrastrukture ekzistuese komunale në kompleksin Kalaja e Kitës - rindërtimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimeve fekale, energjetika
- Ndërtimi i ndërtesave të montazhit në kompleks (këndi i fëmijëve, sipërfaqe për pensionistët, shteg për vrapim dhe këndi për fitnes, pikëpamje, skenë të verës), të cilat përfshijnë punimet përgatitore, punimet për ndërtimin e rregullimit të parterit, vendosjen e bazamenteve të betonit, prokurimin, montazhin dhe instalimin e pajisjeve të parapara (pajisje urbane, pajisje për këndin e fëmijëve, pajisje për fitnes)
- Rikonstruimi i rregullimit të pllajës / parterit, rregullimin e hortikulturës dhe instalimi i pajisjeve urbane, që përfshin punimet e ndërtimit për rregullimin e parterës - zëvendësimi i pllakave të dëmtuara të bekatonit, zbulimi dhe montimi i pllakave të reja jo rrëshqitëse të granitit, instalimi i lëndës dekorative nga bari dhe guri dekorativ i grimcuar, mbi bazat e betonit dhe instalimin e pajisjeve urbane
- Rikonstruimi i shtigjeve të këmbësorëve dhe të trafikut, që përfshin zëvendësimin e pllakave të dëmtuara të bekatonit me shtigje të reja të këmbësorëve dhe punimeve të ndërtimit për gjurmimin e asfaltit të dërrmuar, ngjeshjen dhe instalimin e një shtrese të re bituminoze.

Me riorganizimin e hapësirës dhe shfrytëzimin e lidhjes brenda-jashtë, si dhe rindërtimin e ndërtesës së shkatërruar dhe shëndërrimin e saj në një qendër multimediale, do të futen përmbajtje të reja dhe të ndryshme të tilla si një bar kafe, kino projektme, duke mbajtur koncerte, ngjarje kulturore, seminare, punëtori, etj. dhe pjesëmarrje më të madhe që do të ndodhë vazhdimisht gjatë gjithë vitit. Përmbajtjet e reja që do të futen, si dhe afërsia e kompleksit me qendrën e qytetit, do të kontribuojnë që

ky lokacion të jetë një markë të njohur dhe një pjesë e jetës së përditshme të qytetit, që në veçanti do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe të përfitimit ekonomik të komunës.



Fotografia 8 Pamja e planifikuar e Kalasë së Kitës pas intervenimit projektues

Lokacioni i aktiviteteve



Kalaja e Kitës ndodhet në pjesën lindore të pjesës qendrore të Kërçovës. Është një kodrinë me një bazë rrethore të rrafshuar nga lart, deri në 20 metra lartësi mbi pjesën lindore dhe lumin Temnica (633 m mbi nivelin e detit). Në pjesën perëndimore është e lidhur me një shalë të ulët dhe të gjerë me rrafshnaltën, në të cilën lidhen lumenjtë Osojtit, Zajazit dhe Temnica, duke formuar lumin Treska (Velika Reka). Këtu u rrit bërthama e qytetit mesjetar dhe të sotëm të Kërçovës. Aktualisht është një park (në një gjendje të pakënaqur), me një pllakë përkujtimore nga Lufta e Dytë Botërore në majë të kodrës.

Lokacioni në të cilin do të realizohet nënprojekti, gjendet në zonën qendrore të qytetit të Kërçovës, brenda destinacionit që mbulon rajonin e Rekës dhe rrethinën e tij. Kalaja e Kitës ndodhet në qendër të Kërçovës dhe mbulon një zonë të madhe me bimësi, si dhe një infrastrukturë të caktuar në dispozicion për vizitorët. Kompleksi ka përcaktuar shtigjet e këmbësorëve për rekreacion, shëtitore dhe objekte shoqëruese që në të kaluarën mundësuan përmbushjen cilësore të kohës së lirë, organizimin e ahengejeve dhe manifestime të ndryshme. Megjithëse, në të kaluarën Kalaja e Kitës ishte tërësisht në funksion, në dy dekadat e fundit ajo është jashtë përdorimit.

Kalaja e Kitës paraqet një potencial të madh turistik, në të gjitha bazat e përcaktuara si një atraksion të vazhdueshëm, e cila në të kaluarën është shfrytëzuar tërësisht. Për shkak të gjendjes aktuale të shkatërruar, për momentin ky vend mund të perceptohet si potencial. Në qoftë se, kryhen disa ndërhyrje dhe të vihet në veprim, në pajtim me parashikimet e projektit, Kalaja e Kitës do të bëhet një destinacion

tërheqës, e njohur si një tërheqje turistike, në të cilën gëzimin e tij do ta gjejnë lloje të ndryshme të vizitorëve vendas dhe të huaj. Vendndodhja në qendër të qytetit i mundëson komunikimin, gjegjësisht qasje të këmbësorëve dhe të trafikut, ndërsa maja e kodrës ofron një pamje të bukur të qytetit dhe zonës përreth. Në afërsi të saj ka një numër të madh kapacitetesh hotelierike dhe tregtare që ofrojnë shërbime të ndryshme për ngrënie, zbavitje, fjetje natën etj.

2. Përfshirja dhe qëllimi i PMMJ dhe Plani për menaxhim me trashëgiminë kulturore

PMMJ ka qenë i përgatitur për aktivitetet e parapara në kuadër të nënprojektit të Komunës së Kërçovës - Rivitalizimi i Kalasë së Kitës. PMMJ dhe Plani i Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore përmban përshkrimin e projektit, detajet teknike, vendndodhjen dhe fushëveprimin, në bazë të së cilit janë vlerësuar rreziqet për mjedisin jetësor, si dhe aspektet sociale relevante për rastin. PMMJ dhe Plani i Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore bëjnë identifikimin e masave të qëndrueshme dhe efektive që mund të zvogëlojnë ndikimet e mundshme negative në një nivel të pranueshëm mbi mjedisin jetësor dhe social dhe mbi trashëgiminë kulturore. Zbatimi i masave lehtësuese mbi rreziqet e identifikuar është i detyrueshëm.

PMMJ përbëhet nga një sërë masash institucionale për zbutjen dhe monitorimin gjatë zbatimit të aktiviteteve në mënyrë që të eliminohen ndikimet negative mbi mjedisin jetësor dhe social apo reduktimin e tyre në një nivel të pranueshëm. Plani, gjithashtu, përfshin aktivitetet e nevojshme për zbatimin e këtyre masave. PMMJ përshkruan detajet teknike për çdo masë zbutëse, duke përfshirë llojin e ndikimit sëbashku me skica, përshkrimin e pajisjeve dhe procedurave për veprim, si dhe ndikimet e mundshme shtesë, vlerësimin e ndikimit mjedisor të këtyre masave dhe siguron një lidhje me planet tjera për zbutjen e nevojshme për projektin (Planin për menaxhimin me trashëgiminë kulturore për nënprojektin Rivitalizimi i Kalasë së Kitës në Komunën e Kërçovës, në shtojcë të këtij PMMJ si Shtojca 1).

Kornizë institucionale dhe juridike

Një nga sfidat më të mëdha për politikën e mjedisit jetësor është arritur një ekuilibër mes dimensionit ekonomik dhe social të zhvillimit, nga njëra anë dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor nga ana tjetër, e cila ofron përdorim më të madh të instrumenteve ekonomike që synojnë mbrojtjen e mjedisit jetësor. Duke njohur efektet e dëmshme të ndotjes së mjedisit jetësor që ndikojnë në cilësinë e jetës së njerëzve, parimet themelore të shtetit për mbrojtjen e mjedisit jetësor shteti i përcakton në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr.52/91, 1/92 (Amandamenti i I dhe II); nr.31/98 (Amandamenti i III); nr.91/01 (Amandamenti i IV-XVIII); nr.84/03 (Amandamenti i XIX); nr.107/05 (Amandamenti i XX-XXX); nr.3/09 (Amendamenti XXX)), si dokumenti më i lartë ligjor në vend. Kushtetuta përcakton se një parim themelor i vlerave themelore është rregullimi dhe humanizimi i hapësirës dhe mbrojtja dhe avancimi i mjedisit jetësor dhe natyrës. Gjithashtu, një nga liritë themelore dhe të drejtat e njeriut është e drejta për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, por është obligim i qytetarëve për të avancuar dhe për të mbrojtur mjedisin jetësor, ndërsa shteti është i obliguar që të sigurojë kushte për ushtrimin e kësaj të drejte të garantuar për qytetarët.

Më poshtë janë paraqitur legjislacioni kombëtar, direktivat e BE-së, standardet ndërkombëtare dhe politikat e Bankës Botërore, të rëndësishme për përgatitjen e PMMJ për zbatimin e Projektit të Rivitalizimit të Kalasë së Kitës.

Procedura e vlerësimit të ndikimit mbi mjedisin jetësor për zhvillimin e projektit

Procedura për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor është kryer në pajtim me Kapitullin XI/neni 76-94 të Ligjit për mjedisin jetësor ("Gazeta zyrtare" nr. 53/05, 81/05 24/07, 159/08 dhe 83/09; 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 163/13, 42/14, 129/15 dhe 39/16) dhe aktet adekuate nënligjore, duke marrë parasysh direktivat e BE-së për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor (Direktiva 85/337 EEC, 97/11/EC, 2003/35/EC dhe 2009/31/EC). Llojet e projekteve dhe kriteret në bazë të të cilave përcaktohet nevoja për kryerjen e procedurës për VNM, të përcaktuara nga Qeveria e RM-së me propozim të organit përgjegjës për çështjet e mjedisit jetësor (MMJPH) dhe në pajtim me Dekretin për përcaktimin e projekteve dhe kriteret mbi bazën e të cilave përcaktohet nevoja për kryerjen e VNM-së ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr.74/05, 109/09 dhe 164/12).

Procedura fillon kur investitori (Propozuesi i Projektit) i cili synon të realizojë një projekt dorëzon Letrën e Qëllimit, në versionin e shkruar dhe elektronik, tek Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapsinor (MEPP - Departamenti i Mjedisit), organi përgjegjës i administratës shtetërore për procedurën e kompletuar. Departamenti i Mjedisit Jetësor është i detyruar të japë një mendim për temën e nevojës për përgatitjen e një Elaborati për mjedisin jetësor dhe Vlerësim për mjedisin jetësor.

Gjatë fazës së përcaktimit të nevojës për zbatimin e procedurës për VNM, MMJPH përcakton nëse duhet të zbatohet një procedurë e VNM për projektin. Për zhvillimin e projekteve që nuk i përkasin listës së projekteve për të cilat duhet të kryhet procedura e VNM, ekzistojnë kërkesa për përgatitjen e "Raportit – Elaboratit për ndikimin në mjedisin jetësor" (i zbatueshëm për projektet e kategorisë B sipas Procedurës për Vlerësimin e Mjedisit jetësor OP 4.0.1 nga Banka Botërore).

Procedura nacionale për vlerësimin e mjedisit jetësor për projektet e vogla

Gjatë procedurës së VNM, gjatë fazës së ekzaminimit, nëse është marrë vendimi se nuk ka nevojë të zbatohet një procedurë për VNM, atëherë investitori duhet të fillojë procedurën për hartimin e elaboratit. Kjo procedurë është e detyrueshme për projektet në shkallë të vogël (për shembull: rindërtimi ose ndërtimi i rrugëve lokale, rrugicat, ndërtimi i sistemeve lokale të furnizimit me ujë për ujë të pijshëm, sistemet e grumbullimit të ujërave të zeza dhe projektet më të vogla) që kanë afat të shkurtër, ndikime të vogla negative mbi mjedisin jetësor.

Ka dy rregullore për përgatitjen e Raportit për vlerësim të ndikimit mbi mjedisin jetësor - Elaborat për projektet e vogla:

- Rregullorja për listën e projekteve për të cilat duhet të përgatitet Elaborat për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor nga ana e investitorit dhe të miratohet nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapsinor ("Gazeta zyrtare" nr. 36/12);
- Rregullore për listën e projekteve për të cilat duhet të përgatitet Elaborat për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor nga ana e investitorit dhe të miratohet nga Kryetari i Komunës ("Gazeta zyrtare" nr. 41/12)

Përmbajtja e Elaboratit për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor duhet të jetë në pajtim me Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e Raportit, në përputhje me procedurat për miratimin e Elaboratit për vlerësim të ndikimit për mjedisin jetësor ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr.132/12). Elaborati për VNM i përmban karakteristikat kryesore të aktiviteteve, ndikimet kryesore të përcaktuara negative dhe pozitive mbi mjedisin jetësor. Programi i thjeshtë për mbrojtjen e mjedisit jetësor përbëhet nga masat për të parandaluar, zbutur dhe kompensuar ndikimet negative në të gjitha elementet e mjedisit jetësor që duhet

të zhvillohen në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe praktikat ndërkombëtare për mjedisin jetësor. Gjatë përgatitjes dhe miratimit të Raportit të VNM-së - Elaborat nuk ka nevojë për debat publik.

Komuna e Kërçovës ka dorëzuar Njoftimin për qëllim me nr.23-512/1 të dt. 23.02.2018, për zbatimin e projektit Rivitalizimi i lokacionit Kalaja e Kitës, deri te MMJPH - Drejtoria e Mjedisit Jetësor. Në lidhje me këtë Njoftim për qëllim, nga ana e MMJPH – Drejtoria e Mjedisit Jetësor ishte dorëzuar Mendim, duke shpjeguar se për këtë projekt NUK DUHET të përgatitet Elaborat për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Listë e rregullativave dhe dokumenteve për masat e propozuara për menaxhimin me mjedisin jetësor

1. Ligji për mjedisin jetësor (“Gazeta zyrtare e RM-së“ nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13,42/14, 44/15, 129/15 dhe 39/16);
2. Ligji për menaxhim me mbeturinat (“Gazeta zyrtare e RM-së“ nr. 68/04, 71/04, 107/07, 102/08, 134/08, 82/09, 124/10, 09/11, 47/11, 51/11, 163/11, 123/12, 147/13, 163/13, 51/15, 146/15, 156/15, 39/16 dhe 63/16);
3. Ligji për mbrojtje nga zhurma në mjedisin jetësor (“Gazeta zyrtare e RM-së“ nr. 79/07, 124/10, 47/11 dhe 163/13);
4. Ligji për cilësinë e ajrit të ambientit (“Gazeta zyrtare e RM-së“ nr. 67/04, 92/07, 35/10, 47/11, 59/12, 100/12, 4/13 dhe 10/15);
5. Ligji për mbrojtje të natyrës (“Gazeta zyrtare e RM-së“ nr. 67/04, 14/06, 84/07, 35/10, 47/11, 148/11, 59/12, 13/13, 163/13, 41/14, 146/15, 39/16 dhe 63/16);
6. Ligji për menaxhim me paketimin dhe mbeturinat nga paketimi (“Gazeta zyrtare e RM-së“ nr. 161/09, 17/11, 47/11, 136/11, 6/12, 39/12, 9/13 dhe 39/16);
7. Ligji për siguri dhe shëndet në RM (“Gazeta zyrtare e RM-së“ nr. 92/07, 136/11, 23/13 ,25/13 137/13, 164/13, 158/14, 15/15, 129/15 dhe 192/15)
8. Ligji për ujërat (“Gazeta zyrtare e RM-së“ nr. 87/08, 6/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 23/12, 23/13, 163/13, 180/14 dhe 146/15);
9. Ligji për ndërtim (“Gazeta zyrtare e RM-së“ nr. 130/09, 124/10, 18/11, 36/11, 54/11, 59/11, 13/12, 144/12, 79/13, 137/13, 163/13, 27/14, 28/14, 42/14, 44/15, 129/15 dhe 39/16)
10. Ligji për mbrojtje dhe siguri të vendit të punës (“Gazeta zyrtare e RM-së“ nr. 92/07, 136/11, 23/13 dhe 25/13)
11. Ligji për mbrojtje të trashëgimisë kulturore (“Gazeta zyrtare e RM-së“ nr. 20/04, 71/04, 115/07, 18/11, 148/11, 23/13, 137/13, 164/13, 38/14, 44/14, 199/14 dhe 154/15);

Politika të Bankës botërore që kanë të bëjnë me projektin

P. 4.01 Vlerësim i mjedisit jetësor

Për projektet e propozuara për financim nga Banka Botërore, për të siguruar qëndrueshmërinë dhe mirëmbajtjen e tyre në aspektin e mjedisit jetësor dhe duke përmirësuar kështu vendimmarrjen, nevojitet një vlerësim i mjedisit jetësor (VMJ). VMJ është një proces gjerësia, thellësia dhe lloji i analizës së të cilit varet nga natyra, shtrirja dhe ndikimet e mundshme mbi mjedisin jetësor të projektit të propozuar, me çka vlerëson rreziqet e mundshme të projektit mbi mjedisin jetësor, si dhe ndikimet e tyre në fushën e mbuluar me projektin.

Sipas kategorizimit të Bankës Botërore, ekzistojnë 4 kategori projektesh të tipit A, B, C, FI, për të cilat marrësi ka detyrimin për të zbatuar VMJ. Kjo politikë PP/BP 4.01 Vlerësimi i mjedisit jetësor është

një pjesë integrale e projektit për konkurrencën lokale dhe rajonale. PKLR është kategorizuar si një projekt i kategorisë B, duke supozuar se një nivel i caktuar i ndikimit negativ mbi mjedisin jetësor mund të pritët në fazën e zbatimit, por asnjëri prej tyre nuk është i rëndësishëm dhe afatgjatë. Politikat e aplikuara në mënyrë adekuate zvogëlojnë rrezikun e ndikimeve të dëmshme për njerëzit ose mjedisin jetësor. Si rezultat i perceptimit të efekteve të projektit mbi mjedisin jetësor, pra aspektet sociale, aktivizohen politikat mbrojtëse të Bankës Botërore. Shtrirja e VMJ për një nënprojekt të kategorisë B mund të ndryshojë nga një nënprojekt në tjetrin. VMJ shqyrton ndikimet negative dhe pozitive të nënprojektit dhe rrjedhimisht masat e nevojshme që duhet të ndërmerren për të parandaluar, minimizuar, zbutur ose kompensuar ndikimet negative.

Të gjitha aktivitetet e projektit (dhe të nënprojekteve) duhet të zbatohen në përputhje me politikat e Bankës Botërore, si dhe procedurat dhe rregulloret kombëtare, ku zbatohen rregulla më të rrepta. Korniza e menaxhimit me mjedisin jetësor (KMMJ), e cila siguron udhëzime dhe procedura për analizë të thellë për mjedisin jetësor për projektin e përgjithshëm, fokusohet në hartimin e udhëzimeve dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e nënprojekteve sipas Komponentës së 3. Do të mbështeten vetëm nënprojektet e kategorive B dhe C, ndërsa projektet në kategorinë A do të përjashtohen. Varësisht nga madhësia dhe fushëveprimi i nënprojekteve të kategorisë B, do të kryhen vlerësime shtesë të mjedisit jetësor, të cilat do të rezultojnë në PMMJAS ose PMMJ, gjegjësisht lista me aktivitete për PMMJ për punët më të vogla.

Për projektet e kategorisë B është i detyrueshëm vlerësimi i çdo ndikimi të mundshëm negativ që lidhet me nënprojektin e propozuar, duke identifikuar mundësitë potenciale për të përmirësuar mjedisin jetësor dhe masat e nevojshme për të parandaluar, minimizuar dhe zbutur ndikimet negative. Përfshirja dhe formati i VMJ do të ndryshojnë në varësi të nënprojektit, por zakonisht do të jetë më i ulët se Vlerësimi i ndikimit të mjedisit jetësor, zakonisht në formën e një PMMJAS.

Për nënprojektet e kategorisë B+, shfrytëzuesi/marrësi është përgjegjës për përgatitjen e a) një VNMJ të plotë (në varësi të mendimit të marrë nga institucioni përgjegjës, si dhe PMMJAS ose b) një formë e thjeshtë e VNMJ - Raport për të kontrolluar me PMMJAS duke përfshirë, nëse është e nevojshme, një gamë të reduktuar të VNMJ, e cila kërkon një përshkrim të shkurtër të ndikimeve, përkufizimin e masave lehtësuese dhe miratimin e praktikave të pranuar për veprim dhe monitorim. Shpenzimet për masat zbutëse do të përfshihen në VNMJ ose PMMJAS dhe përfshihen në një studim të fizibilitetit dhe më vonë në përlllogaritjen. Dokumenti i përgatitur për VNMJ, në varësi të mendimit të institucionit përgjegjës (MMJPH), do të përfshijë aneksin e PMMJAS të përgatitur sipas OP 4.01 nga Banka Botërore. Për nënprojektet që duhet të jenë të kualifikuar, duhet të merren të gjitha lejet e kërkuara sipas rregulloreve kombëtare dhe të njëjtat të dorëzohen tek institucioni i autorizuar që kryen vlerësimin.

P/BP 4.11 Resurse fizike kulturore

Politika e Resurseve kulturore fizike aktivizohet kur nënprojektet brenda nënkomponentit 3, infrastruktura, potencialisht përfshijnë projekte me ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi resurset e paluajtshme kulturore. Për nënprojektet që aktivizojnë këtë politikë, do të përgatitet Plani i menaxhimit të trashëgimisë kulturore. Ky plan mund të jetë pjesë e PMMJAS ose PNMJ.

Kjo praktikë u referohet resurseve fizike në fushën e kulturës, të përcaktuar si objekte të luajtshme ose të paluajtshme, strukturave, grupeve të strukturave dhe peizazheve që kanë rëndësi arkeologjike, paleontologjike, historike, arkitektonike, fetare, estetike apo rëndësi të tjera kulturore. Resurset fizike kulturore mund të jenë mbi ose nën tokë ose nën ujë. Rëndësia e tyre kulturore mund të jetë në nivel lokal, rajonal ose kombëtar ose brenda bashkësisë ndërkombëtare. Resurset fizike kulturore janë të rëndësishme si resurse të informacionit të vlefshëm shkencor dhe historik, si vlerë e zhvillimit

ekonomik dhe social dhe si një pjesë përbërëse e identitetit kulturor. Shumica e resurseve fizike kulturore janë tërheqjet turistike dhe është e mundur që disa prej tyre të jenë vende ku projektet potenciale nga Komponenti 3 i PKLR mund të zbatohen, sepse kjo Rregullore PP/BP 4.11 do të merret parasysh në kuadër të analizave të mëtutjeshme.

Masa institucionale

Komuna e Kërçovës është e vendosur në pjesën perëndimore të Republikës së Maqedonisë, në një distancë prej rreth 110 km nga kryeqyteti i Shkupit dhe i takon rajonit jugperëndimor. Një karakteristikë e kësaj komune është se në vitin 2013, me organizimin e ri territorial, ka pasur një bashkim të pesë komunave: Kërçovë, Dërgovë, Vraneshticë, Zajaz dhe Oslome, të cilat tani janë të përfshira në përbërjen e Komunës së Kërçovës, qendra administrative e të cilës është e vendosur në qytetin e Kërçovës. Kur do të mblidhet numri i banorëve të pesë komunave të mëparshme të veçanta, në bazë të regjistrimit të fundit të kryer në vitin 2002, numri total i popullsisë në Kërçovë është 56.739. Komuna ka karakterin multi-etnik dhe multikulturor, me përfaqësimin e bashkësive etnike që jetojnë në vend, kryesisht nga shqiptarët dhe maqedonasit. Komuna e Kërçovës mbulon një sipërfaqe prej 837 km², me 79 vendbanime në territorin e saj. Për shkak të veçantisë së zonës ku ato janë të vendosura vendbanimet në komunë, ku është shqiptuar kalimi nga pjesa e lartë malore në pjesën e ulët, në strukturën e relievit mund të dallohen dy tërësi tektonike dhe atë pjesë malore dhe pjesë kodrinore - luginë. Lugina e Kërçovës përfaqëson një tërësi natyrore të formuar në mënyrë të qartë, e rrethuar nga male të larta nga të gjitha anët. Për shkak të vendndodhjes dhe relievit të lartë, vendbanimet shtrihen në një lartësi prej 620 deri në 1,150 metra.

Qyteti i Kërçovës është një qendër urbane dhe administrative, ku gravitojnë vendbanimet e afërta. Ajo është vendosur në një lartësi prej 620-650 metra. Qyteti i Kërçovës është vendi më i dendur i populluar në komunë, ku jeton 52% e popullsisë së përgjithshme në komunë. Dendësia e popullsisë është 615 banorë për 1 km².

NJVL Kërçovë, si dhe komunat tjera në vend, funksionon në kuadër të kompetencave të përcaktuara me Ligjin për vetëqeverisje lokale, të cilat kanë të bëjnë me: planifikimin urban dhe rural, mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës, planifikimin dhe menaxhimin e zhvillimit ekonomik lokal, organizimin dhe menaxhimin e infrastrukturës komunale, zhvillimin e kulturës dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, zhvillimin e sportit dhe rekreimit, organizimin dhe ndërtimin e objekteve për kujdesin social dhe kujdesin ndaj fëmijëve, organizimin dhe përmirësimin e arsimit, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të organizatave dhe objekteve të kujdesit shëndetësor parësor, masave për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të mirave materiale nga agjencionet ushtarake dhe fatkeqësitë natyrore, mbrojtja nga zjarri. Komponenta për ZHEL është themeli rreth të cilit komuna zhvillon aktivitete të tjera ekonomike dhe jo ekonomike. Prandaj, qasja korrekte dhe strategjike rezultojnë në përmirësimin e potencialit ekonomik të komunës që kontribuon në sigurimin e një jete më të mirë dhe zhvillimit të qëndrueshëm të komunitetit lokal.

Komuna e Kërçovës ka një zyrtar të pavarur të punësuar për mbrojtjen e mjedisit jeshëtor me kompetenca për të kryer inspektimin për mbrojtjen e mjedisit jetësor, përgjegjës për kryerjen e punëve komplekse për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe menaxhimin me mbeturinat. Inspektori për mjedisin jetësor do të marrë pjesë aktive në periudhën e zbatimit të aktiviteteve të projektit, si dhe më pas, në kuadër të projektit Rivitalizimi i Kalasë së Kitës.

Sipas Aktvendimit për shpalljen e Kalasë së Kitës si një monument i kulturës dhe trashëgimisë kulturore me rëndësi të veçantë, Kalaja e Kitës si një zonë e mbrojtur ka një regjim të garantuar të mbrojtjes. Për aktivitetet e projektit që do të zbatohen në fazën e zbatimit, nga Ministria e Kulturës -

Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore do të jepet leje në bazë të mendimit paraprak të Qendrës Kombëtare të Konservimit - Shkup. Qendra e Ruajtjes lëshoi një mendim që iu dorëzua Drejtorisë për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, ku u sollë Aktvendimi për dhënien e kushteve për mbrojtje dhe konservim, për përgatitjen e Projektit themelor. Kushtet e lëshuara për mbrojtje dhe konservim u integruan në hartimin e projektit, i cili do t'i dorëzohet Drejtorisë për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, me qëllim që në fund të lëshojë leje për zbatimin e aktiviteteve të projektit.

Qëllimi i Planit për menaxhim me mjedisin jetësor dhe Plani për menaxhim me punët e trashëgimisë kulturore / Shpallja publike dhe konsultimet me publikun

Qëllimi i Planit për menaxhim me mjedisin jetësor për projektin "Rivitalizimi i Kalasë së Kitës" është identifikimi në kohë i ndikimeve mbi mjedisin jetësor që do të lindin nga realizimi i aktiviteteve të parashikuara për të cilat janë propozuar masat lehtësuese ose zbutëse për masat për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe periudhën kohore për zbatimin e masave, me personat përgjegjës për zbatimin e Planit dhe shpenzimet e parashikuara.

Plani i përgaditur për menaxhimin me mjedisin jetësor, duke përfshirë Planin për menaxhimin me punët e trashëgimisë kulturore për nënprojektin e propozuar do të jetë pjesë e Kontratës me Kontraktorin i cili është i detyruar të zbatojë masat e parashikuara në përputhje me Planin për zbutje. Inxhinieri mbikëqyrës është i detyruar të monitorojë dhe vlerësojë zbatimin e masave të propozuara në përputhje me Planin e monitorimit dhe të informojë investitorët dhe Zyrën e Projektit (Komuna e Kërçovës dhe Projektin për Konkurrencën Lokale dhe Rajonale (PKLR)).

Publiku do të përfshihet në procedurë për të vlerësuar ndikimin e projektit duke organizuar një diskutim publik në mjediset e Komunës së Kërçovës. Plani i menaxhimit me mjedisin jetësor për nënprojektin do të jetë në dispozicion në formë të shtypur në zyrat e Komunës së Kërçovës dhe PKLR/KZPVRMEP dhe do të publikohet në faqet e internetit të PKLR, Agjencia për promovim dhe mbështetje të turizmit dhe faqen e Komunës së Kërçovës, ku ajo do të jetë në dispozicion për publikun për një periudhë prej 14 ditësh, në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze. Për konsultim me publikun, një formë e shtypur do të jetë në dispozicion në hapësirat e Komunës së Kërçovës. Sëbashku me PMMJAS do të publikohet edhe një thirrje publike për pjesëmarrje në debatin publik (koha dhe vendi do të shpallet në mënyrë shtesë). Debati publik do të organizohet në periudhën e konsultimit të parashikuar. Komuna e Kërçovës menjëherë do të informojë dhe do të ftojë palët e interesuara (OJQ-të lokale, komunitetet e prekura) për të marrë pjesë me idetë dhe komentet e tyre dhe për të kontribuar në debatin publik. Do të caktohet një person për të mbledhur komente mbi Planin për menaxhimin me mjedisin jetësor dhe Planin për menaxhimin me trashëgiminë kulturore botuar në periudhën për shqyrtim publik, dhe gjatë kohës së mbajtjes së diskutimit publik dhe të njëjtat do t'i përfshijë në Raportin nga diskutimi i mbajtur publik që do të jetë pjesë e Planit. Kjo do të mundësojë që komentet përkatëse të merren në konsideratë dhe përfshirjen e përgjigjeve për komentet dhe vërejtjet në Planin final të menaxhimit me mjedisin jetësor dhe Planin e menaxhimit me punët e trashëgimisë kulturore.

3. Ndikimet mbi mjedisin jetësor dhe trashëgiminë kulturore

Projekti i Rivitalizimit të Kalasë së Kitës është një ndërhyrje pozitive dhe e domosdoshme, e cila do të përfitojë duke përmirësuar pamjen e kështjellës që do të ndikojë më tej në imazhin e qytetit, në zhvillimin më të mirë ekonomik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet dhe duke ofruar momente të këndshme për vizitorët e huaj. Megjithatë, ka disa ndikime negative në mjedis, të cilat janë kryesisht afatshkurtra dhe të kufizuara në periudhën e zbatimit të aktiviteteve të parashikuara të projektit.

Ky kapitull është përpunuar në mënyrë që të tregojë rreziqet potenciale, gjegjësisht të mundshme dhe efektet e dëmshme mbi mjedisin jetësor, popullsinë dhe fuqinë punëtore të përfshirë në fazat e ndryshme të projektit. Analiza e ndikimit në mjedisin jetësor merr në konsideratë çdo ndryshim të mundshëm, negativ ose pozitiv, mbi aspektet biologjike, fizike, kimike dhe socio-ekonomike të mjedisit jetësor (përfshirë aspektet e shëndetit të popullatës që jeton ose punon në zonën e projektit), të cilat mund të lindin nga zbatimi i projektit. Niveli i ndryshimit përcakton rëndësinë e tij, i cili vlerësohet në bazë të gjerësisë së zonës ku ndihet ndikimi, kohëzgjatja e ngjarjes, mundësia e shfaqjes dhe intensiteti i saj. Vlerësimi i përgjithshëm, përqendrohet kryesisht në ato ndryshime të rëndësishme. Ky dokument paraqet detajet e ndikimeve të mundshme të projektit dhe efektet e tyre mbi receptorët kryesorë (banorët, rrjedhat ujore, toka...). Në përgjithësi, ndikime relativisht të kufizuara do të krijohen në fazën e ndërtimit të projektit, ndërsa ndikimet pozitive, sidomos nga faza operative të kompleksit të rigjallëruar, do të reflektohen në të gjitha marrësit dhe zonat e mjedisit jetësor, si dhe në jetën e përgjithshme.

